



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUHTETUESE
KOLEGJI I POSÇËM I APELIMIT
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

RAPORT

MBI

MONITORIMIN E FONDEVE BUXHETORE TË VITIT 2023
PËR KOLEGJIN E POSÇËM TË APELIMIT

SHKURT 2024

PËRMBAJTJA

1	HYRJE	3
2	RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE PËR VITIN 2023.....	4
	2.1 INFORMACION MBI VOLUMIN DHE MADHËSINË E NDRYSHIMIT TË BUXHETIT	6
	2.2 ANALIZA FINANCIARE ANALITIKE	7
	2.2.1 Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)	7
	2.2.2 Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601).....	8
	2.2.3 Shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera (llogaria ekonomike 602)	8
	2.2.4 Shpenzimet për Trans. për Buxh. Fam. & Individ (llogaria ekonomike 606).....	11
	2.2.5 Shpenzimet kapitale (231).....	11
3	ANEKS 1 SITUACION I SHPENZIMEVE OPERATIVE 602 PËR VITIN 2023	12

1 HYRJE

Ky dokument përfaqëson raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuara që ka në fushën e përgjegjësisë Kolegji i Posaçëm i Apelimit (Kolegji). Ky dokument ofron informacion të detajuar mbi ecurinë e zbatimit të buxhetit dhe mbulon periudhën 1 janar 2023 deri më 31 dhjetor 2023.

Monitorimi i zbatimit të buxhetit të vitit 2023, për Kolegjin përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara. Strukturat e Kolegjit kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetorë me qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar në përputhje me planin e ecurisë së institucionit dhe të gjitha kërkesave ligjore. Nëpërmjet këtij raporti monitorimi, evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të Kolegjit në krahasim me planin e miratuar, të detajuar në nivel treguesish të performancës.

Analiza e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor i mundëson institucionit orientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit. Me qëllim për të kontribuar në proceset bazë të misionit dhe objektivave të institucionit, buxheti i Kolegjit është mbështetur plotësisht në udhëzimet standarde të hartimit të buxhetit mbi bazë të treguesve të performancës, por gjithashtu dhe monitorimin e realizimit buxhetor mbështetur mbi ato tregues të planifikuar gjatë hartimit të programit buxhetor afatmesëm.

Ky raport zyrtar do të shërbejë si një pasqyrë e rëndësishme përmes së cilës Kolegji do të synojë lidhjen e kostove buxhetore me produktet e performancës, si forma më e mirë e buxhetimit dhe vlerësimit financiar të ecurisë së institucionit. Forma dhe përmbajtja e raportit të monitorimit u krye sipas Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore*”.

Ekipi i Menaxhimit të Programit “*Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar*” gjatë përgatitjes së raportit zhvilloi komunikime intensive me strukturat përgjegjëse të Kolegjit, me qëllim paraqitjen e drejtë dhe të qartë të arritjeve dhe problematikave të hasura gjatë periudhës raportuese.

Misioni i Kolegjit është “*Përmbushja e funksioneve dhe kompetencave ligjore për garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut, tek institucionet e këtij sistemi*”.

Objektivi i Kolegjit është “*Të shqyrtojë çështjet e ankimuarra nën juridiksion, bazuar në një proces të rregullt ligjor*”.

Mbulimi i prioriteteve të institucionit me fondet e mjaftueshme buxhetore është një synim, i cili do t'i sigurojë institucionit qëndrueshmërinë dhe integritetin e nevojshëm për arritjen e rezultateve të sipërcituara. Mund të ekzistojë një mospërputhje jomateriale ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur nëpër tabela dhe grafikë për shkak të rumbullakimeve. Vlerat e plota paraqiten në anekset bashkëngjitur këtij raporti.

Kolegji, për përmbushjen e misionit të tij, për vitin 2023, administron dhe menaxhon fondet publike, në bazë të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.84/2022, datë 24.11.2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe në bazë të akteve normative të dala gjatë vitit apo Vendimeve të Këshillit të Ministrave.

2 RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE PËR VITIN 2023

Buxheti i Kolegjit është miratuar me ligjin nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, ku në total rezultojnë të jetë planifikuar si plan fillestar një vlerë prej 207,400,000 lekë sipas shkresave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23774/48, datë 20.01.2023 dhe nr. 7191, datë 19.04.2023. Gjatë kësaj periudhe këto burime financiare, Kolegji i ka përdorur në funksion të përmbushjes së plotë të detyrimeve të miratuara me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe Vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 01, datë 16.01.2023, për detajimin e fondeve buxhetore për vitin 2023.

Kanë ndodhur disa ndryshime mbi planin fillestar, të cilat janë të detajuara në kapitujt më poshtë. Si rrjedhim i kësaj, plani i rishikuar rezultojnë të jetë 272,819,000 lekë.

Kolegji i Posaçëm i Apelit është një institucion kushtetues i pavarur që ka si qëllim rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë në shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Kolegji ushtron funksionin e tij në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pas vendimarrjes së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe pas paraqitjes ose jo të ankimit nga subjektet e rivlerësimit apo Komisioneri Publik ndaj vendimit të KPK-së. Ai ka gjithashtu juridiksion të shqyrtojë shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe shqyrton ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

Në kërkesat buxhetore për vitin 2023, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka përcaktuar si produkt kryesor në realizimin e objektivit, “Çështje të ankimuar/shqyrtuara” me një plan vjetor në masën 90 çështje të regjistruara gjatë vitit 2023. Në këtë parashikim është përfshirë numri i ankimeve që parashikohet të paraqiten gjatë vitit 2023, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të Juridiksionit të Rivlerësimit (JR), si dhe numri i ankimeve/kërkesave në kuadër të Juridiksionit Disiplinor (JD). Gjatë vitit 2023, në Kolegji janë regjistruar 57 çështje në kuadër të JR-së dhe 4 çështje në kuadër të JD-së, si dhe kërkesa të tjera procedurale për të dyja juridiksionet. Gjatë kësaj periudhe, Kolegji ka dhënë vendime për 55 çështje në kuadër të JR-së, për 4 çështje në kuadër të JD-së, si dhe janë dhënë vendime lidhur me kërkesa të tjera procedurale të regjistruara në Kolegji.

Në fund të vitit 2023, situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit, krahasuar me planin, sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi financiar informatik i qeverisë, të datës 31.01.2024, paraqitet si më poshtë:


RAPORTI I SHPENZIMEVE TË PROGRAMEVE SIPAS LLOGARIVE EKONOMIKE

Vlera në mijë lekë

Art.	Emërtimi	Fakt 2022	Buxhet fillestar 2023 sipas ligjit 84/2022	Buxhet rishikuar 2023	Fakt 2023
600	Paga	159,624	166,100	233,694	233,692
601	Sigurime Shoqërore	12,951	15,660	17,721	17,721
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	15,044	23,640	18,040	11,720
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	8,151	-	1,364	889
230/231	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	1,355	2,000	2,000	954
	Total	197,125	207,400	272,819	264,976

Pesha specifike sipas llogarive ekonomike të shpenzimeve të planifikuara mbi totalin e shpenzimeve, paraqitet sipas figurës të mëposhtme:

STRUKTURA E SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA VS REALIZIMIT 2023




Duke marrë në analizë peshën e shpenzimeve sipas llogarive ekonomike mbi totalin e buxhetit të Kolegjit, ashtu siç mund të konstatohet në figurën më lart, pjesën më të madhe të planit të shpenzimeve buxhetore e zënë llogaria “Paga dhe Sigurime” me rreth 92%, pas saj vjen “Mallra dhe shërbime të tjera” me rreth 7%, ndërkohë që “Shpenzimet kapitale” dhe llogaria e shpenzimeve kapitale zë një peshë më të vogël rreth 1%.

Duke u mbështetur mbi veprimtarinë bazë të institucionit, kjo shpërndarje e planit të shpenzimeve buxhetore lidhet drejtpërdrejtë me natyrën e punës të Kolegjit.

Nëse do të marrim në analizë peshën e llogarive ekonomike, ndërmjet atyre të planifikuara dhe të realizuara sipas figurës të mësipërme, evidentohet një ruajtje e peshës së këtyre shpenzimeve, si në buxhetin e planifikuar, ashtu edhe në atë të realizuar për vitin 2023.

Qëndrueshmëria financiare e institucionit dhe ndjekja me rigorozitet e procedurave të menaxhimit financiar publik, kanë udhëhequr veprimtarinë administrative të Kolegjit. Gjatë kësaj periudhe, e në vazhdim, synohet vijimi i konsolidimit financiar dhe administrativ të institucionit me qëllim arritjen plotësisht të realizimit buxhetor dhe treguesve të performancës të përcaktuar në programin buxhetor afatmesëm 2024-2026.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024, do të vazhdohet të synohet përdorimi me eficiencë dhe efektivitet maksimal i burimeve financiare në raport me rritjen e nivelit të performancës së treguesve të zbatimit të legjislacionit në fuqi.



2.1 INFORMACION MBI VOLUMIN DHE MADHËSINË E NDRYSHIMIT TË BUXHETIT

Për vitin 2023, buxheti i miratuar sipas ligjit nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, ishte në vlerën 207.4 milion lekë. Gjatë vitit buxheti pësoi ndryshime, të cilat konsistojnë në ndryshime me VKM, shtesa të fondit të veçantë dhe shtesa në fondin e shpenzimeve të personelit.

Tabela më poshtë paraqet planin e rishikuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore.

Fond i veçantë

- Fondi i veçantë sipas shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 4524, datë 07.03.2023;

Vendime të Këshillit të Ministrave

- VKM nr. 437, datë 19.07.2023, “Për shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për disa institucione të pavarura, të krijuara me ligj” dhe shkresës nr. 17452/1, datë 03.10.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- VKM nr. 755, datë 20.12.2023, “Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për disa institucione të pavarura të krijuara me ligj”, sipas Aktit Normativ nr. 6, datë 14.12.2023 dhe shkresës nr. 1377/1, datë 26.12.2023, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- VKM nr. 834, datë 28.12.2023, “Për një ndryshim në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar dhe për shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar për disa institucione” dhe shkresës nr. 23944/1, datë 29.12.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;

- VKM nr. 795, datë 28.12.2023, “Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të Acquis (Screening), në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian”;
- Shtesa e fondit për të financuar rritjen e pagave, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 31.05.2023, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, e cila u financua nga buxheti i shtetit nga fondet rezervë, të miratuara për vitin 2023, sipas shkresave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 12450/2, datë 27.07.2023 dhe nr. 17750/1, datë 12.10.2023.

Rishikimi i fondeve buxhetore

në mijë lekë

Llog.	Plani fillestar (Ligji 84/2022)	Rialokim per shpenzime celulare	Rialokim (shkr. nr. 20645/1 MFE)	Shtesa nga fond i vecante	Shtesa me VKM 755 date 20.12.2023	Shtesa me VKM nr. 437 date 19.7.2023	Shtesa VKM nr. 325 dhe nr. 326	Shtesa me VKM nr. 325 dhe nr. 326	Akordim fondi (shkr.nr.23 944/1 MFE dhe VKM nr.834)	Shtesa me VKM 795 date 28.12.2023	Shtesa me VKM 795 date 28.12.2023	Plan i rishikuar
600	166,100	-	2,350	-	25,000	15,340	6,640	15,200	2,109	640	315	233,694
601	15,660	-	2,150	-	-	260	760	1,000	(2,109)	-	-	17,721
602	23,640	(1,100)	(4,500)	-	-	-	-	-	-	-	-	18,040
606	-	1,100	-	264	-	-	-	-	-	-	-	1,364
231	2,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2,000
	207,400	0	0	264	25,000	15,600	7,400	16,200	0	640	315	272,819

2.2 ANALIZA FINANCIARE ANALITIKE

Të analizuara sipas llogarive ekonomike analitike paraqiten:

2.2.1 Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)

Fondet e parashikuara për këtë zë sipas planit të rishikuar vjetor janë në vlerën e 233.694 milionë lekë, të cilat janë realizuar 100 % e planit të rishikuar. Buxheti i rishikuar për vitin 2023, përbën 86% të buxhetit total vjetor.

Kjo vlerë përfshin pagat e punonjësve të strukturës organike prej 57 punonjësish, të miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 35/2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 92/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit” dhe pagat për 7 (shtatë) punonjës me kontratë të përkohshme, përcaktuar në VKM-në nr. 56, datë 01.02.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023.

Gjatë kësaj periudhe, llogaritja e pagave dhe e sigurimeve shoqërore për gjyqtarët dhe këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, është kryer për periudhën janar - mars 2023, sipas arsyetimit të bërë në vendimin nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e pikës 5 të nenit 12 të ligjit 96/2016, si dhe për periudhën prill - dhjetor 2023, sipas ligjit nr. 33, datë 25.05.2023, “Për një ndryshim në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Këshilli i Ministrave, në vendimin nr. 437, datë 19.07.2023, “Për shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për disa institucione të pavarura, të krijuara me ligj”, ka përcaktuar një shtesë në buxhetin e miratuar

për vitin 2023, për institucionin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në vlerën 15.6 milion lekë, për përballimin e efekteve financiare nga data 1 prill 2023 - 31 dhjetor 2023, të përcaktimit ligjor të pagës referuese bazë të magjistratit.

Gjithashtu gjatë vitit 2023, janë kryer pagesat e efektit prapaveprues në përlllogaritjen e pagës së gjyqtarëve dhe këshilltarëve të Njesisë së Shërbimit Ligjor, sipas arsytimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 35, datë 22.11.2022 (bazuar në Vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 52, datë 30.05.2023). Gjithashtu bazuar në VKM -në nr. 755, datë 20.12.2023, “Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për disa institucione të pavarura, të krijuara me ligj”, është kryer pagesa e efektit prapaveprues për periudhën prill 2019 - shkurt 2022.

Bazuar në Vendimet e Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 85, datë 27.07.2023 dhe nr. 105, datë 18.12.2023, është kryer pagesa e vështirësisë në masën e 2 (dy) pagave mujore, për këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor.

Bazuar në VKM-në nr. 834, datë 28.12.2023, “Për një ndryshim në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar, dhe Vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 108, datë 29.12.2023, është kryer pagesa për shpërblimin e punonjësve të Kolegjit.

Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 795 , datë 28.12.2023, “Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të Acquis (Screening), në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian” miratoi shpërblimin për paraqitje të mirë të Republikës së Shqipërisë në procesin e shqyrtimit analitik të acquis (screening), në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian, zhvilluar midis datave 15 shtator 2022 deri më 24 nëntor 2023. Për këtë qëllim u alokua nga Ministria e Financave fondi 955 mijë lekë për Kolegjin, i cili u përdor sipas parashikimit në vendim për 3 punonjës të Kolegjit.

2.2.2 Shpenzimet për sigurime shoqërore (Ilogaria ekonomike 601)

Fondet e parashikuara për këtë zë sipas planit të rishikuar vjetor janë në vlerën e 17.721 milionë lekë, të cilat janë realizuar 100 % e planit të rishikuar. Buxheti i rishikuar për vitin 2023 përbën 6% të buxhetit total vjetor.

Fondi për kontributet e detyrueshme të sigurimeve është i lidhur me marrëdhëniet e punësimit dhe në përpjesëtim të drejtë me shpenzimet për paga, si rrjedhojë argumentet që lidhen me fondin e pagave, vlejné edhe për këtë zë.

2.2.3 Shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera (Ilogaria ekonomike 602)

Në këtë zë përfshihen një gamë e gjerë materialesh dhe shërbimesh të domosdoshme për mbështetjen e veprimtarisë institucionale operacionale. Buxheti fillestar në këtë zë është në vlerën e 23.64 milionë lekë.

Buxheti i rishikuar, pas transferimit të fondit në vlerë 1.1 milionë lekë nga artikulli 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” në artikullin 606 “Trans. për Buxh. Fam. & Individ” për mbulimin e shpenzimeve të telefonisë celulare për gjyqtarët e Kolegjit dhe transferimit të fondit në vlerë 4.5 milionë lekë në zërin e shpenzimeve të personelit është 18.04 milionë lekë dhe zë 7% të planit të rishikuar.

Buxheti i detajuar në shpenzime operative, për vitin 2023, është realizuar 11.72 milionë lekë nga 18.04 milionë lekë të planifikuara.

Në mënyrë të detajuar shpenzimet për mallra dhe shërbime paraqiten në tabelën në vijim.

<i>N/artik</i>	<i>Struktura e llogarive</i>	<i>Plan vjetor</i>	<i>Fakt</i>	<i>Plan-Fakt</i>	<i>Realizim %</i>
602	MALLRA DHE SHËRBIME TE TJERA	18,040,000	11,687,261	6,352,739¹	65%
1	Materiale zyre dhe të përgjithshme	904,000	826,040	77,960	91%
2	Materiale dhe shërbime speciale	607,000	431,524	175,476	71%
3	Shërbime nga të tretë	3,198,400	3,000,155	198,245	94%
4	Shpenzime transporti	512,000	467,490	44,510	91%
5	Shpenzime udhëtimi	764,000	734,870	29,130	96%
6	Mirëmbajtje të zakonshme	850,000	822,600	27,400	97%
7	Shpenzime për qeramarije	1,450,000	1,428,000	22,000	98%
8	Shpenzime të tjera operative	9,754,600	3,300,079	5,757,018	41%

Gjatë vitin 2023, janë kryer pagesa për të shlyer detyrimet sipas kontratave dhe faturave sipas procedurave përkatëse. Shpenzimet janë realizuar për pagesat e detyrimeve utilitare dhe detyrime prioritare: si energji elektrike; ujë; shërbime postare; si dhe taksa blerje karburanti; shlyerja e detyrimeve kontraktuale; prokurimet për blerjen e mallrave dhe shërbimeve. Gjithashtu në varësi të ecurisë së planit gjatë vitit janë kryer edhe rishikime brenda shpenzimeve korrente për të menaxhuar fondet buxhetore me eficientë.

2.2.3.1 Materiale zyre dhe të përgjithshme

Në këtë nënartikull buxhetor përfshihen shpenzimet materiale si: kancelari, materiali higjeno sanitare, materiale elektrike, tonera dhe artikuj si këto. Nga 904 mijë lekë të planifikuara janë përdorur rreth 826 mijë lekë ose 91%.

2.2.3.2 Materiale dhe shërbime speciale

Në këtë nënartikull bëjnë pjesë shpenzimet lidhur me shpenzime specifike si: abonimet në shtypin e shkruar, regjistra specifike të protokollit, kodekse, uniforma për seancat gjyqësore, dizinfektim ambjentesh, e të tjera specifike. Nga 607 mijë lekë të planifikuara janë përdorur rreth 431.2 mijë lekë ose 71%.

2.2.3.3 Shërbime nga të tretë

Në këtë nënartikull bëjnë pjesë shpenzimet që në përgjithësi janë utilitare si shpenzime për energji elektrike, furnizim me ujë, shpenzime postare (postim dokumentacioni, abonim në shtypin e shkruar), telefoni fikse, si dhe publikime në media të vendeve të shpallura vakante në institucion. Në zërat ka edhe kursime si psh tek shpenzimet celulare (të kontraktuara më kontratë institucionale Kolegji - Shoqëria One Albania), sepse janë përdorur paketa të shërbimit celular me vlerë më të ulët sesa kuota kufi e përcaktuar me Vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 28, datë 1.12.2020, ndryshuar me Vendimin nr. 23, datë 05.02.2021. Këto fonde janë rialokuar aty ku ka pasur prioritete. Nga 3.198 milionë lekë të planifikuar janë përdorur 3 milionë lekë ose 94%.

¹ Jemi në proces rakordimi me degën e thesarit të rrethit për shumën 33 mije lekë.

2.2.3.4 Shpenzime transporti

Në këtë nënartikull bëjnë pjesë shpenzimet që lidhen me pjesën e këmbimit të makinave, goma bateri, karburantit, vendparkimi për automjetin e Kolegjit, si dhe siguracioni i detyruar i automjetit. Fondi për këto zëra është përdorur në varësi të nevojave që ka pasur riparimi ose mirëmbajtja e automjetit. Nga 512 mijë lekë të planifikuara janë përdorur 467.5 mijë lekë ose 91%.

2.2.3.5 Shpenzime udhëtimi

Në këtë nënartikull janë kryer shpenzime për një shërbim pune të titullarit të institucionit jashtë shtetit, si dhe vizitën studimore të organizuar në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar - IRZ, me temë “Etika gjyqësore dhe përgjegjësia disiplinore e gjyqtareve dhe gjyqtarëve” zhvilluar në datat 13 -17 nëntor 2023, në Karlsruhe (Gjykata e Shërbimit të Federatës në Gjykatën e Lartë Federale), Shtutgart (Gjykata e Apelit Shtutgart dhe Gjykata Administrative Shtutgart) dhe Strasburg (Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut) në vlerën 734.8 mijë lekë. Nga 764 mijë lekë të planifikuara janë përdorur 734.8 mijë ose 96%.

2.2.3.6 Mirëmbajtje të zakonshme

Në këtë nënartikull janë kryer shpenzime për mirëmbajtje të sistemeve/pajisjeve TIK , të sistemit elektrike dhe vaji dhe filtrave që duhen për mirëmbajtjen e makinës. Pjesë e këtij fondi është edhe marrëveshja kuadër nr. 519/31 prot., datë 04.08.2023 lidhur midis Kolegjit dhe operatorit ekonomik “Atom” shpk, me objekt “Mirëmbajtje për servera, kompjutera, pajisje zyre”, për të cilën janë ekzekutuar për vitin 2023, dy minikontrata në vlerën totale 704.4 mijë lekë. Nga 850 mijë lekë të planifikuar janë përdorur 822.6 mijë lekë ose 97%.

2.2.3.7 Shpenzime për qeramarrje

Në këtë nënartikull janë kryer shpenzime për qeranë e ambjenteve shtesë dhe janë përfshirë shpenzime që u përkasin kontratave nga viti 2022 dhe kontratave të lidhura gjatë vitit 2023. Janë planifikuar shpenzime në vlerën 1.45 milionë lekë dhe janë përdorur 1.428 milionë lekë ose 98%.

2.2.3.8 Shpenzime te tjera operative

Në këtë nënartikull bëjnë pjesë shpenzime për: sigurimin e jetës, shëndetit dhe pronës, shpenzime për taksa të ndryshme, licenca firewall, microsoft office dhe zoom meeting etj. Nga 9.754 milionë lekë të planifikuara janë përdorur 3.997 milion lekë ose 41%. Peshën më të madhe të këtij fondi e zë “Sigurimi i jetës, shëndetit dhe pronës” në vlerë rreth 8.7 milionë lekë.

Për vitin 2023, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Prokurimeve të Përqëndruara u bë i mundur realizimi i procedurës së prokurimit me objekt “Sigurimi i jetës, shëndetit dhe pasurisë për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit”, e ndarë në dy Lote. Për Lotin I - “ Sigurimi i jetës për gjyqtarët, personat e lidhur të gjyqtarëve, këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, Sekretarin e Përgjithshëm dhe Drejtorët e Drejtorive”, Marrëveshja Kuadër nr. 67/7 prot., datë 02.10.2023, protokolluar në Kolegj me nr. 517/15 prot., datë 12.10.2023, nënshkruar midis Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqëndruara dhe operatorit ekonomik “ Sigal Life Uniqa Group Austria” SH.A. me fond të marrëveshjes 2,927,666 (dy milionë e nëntëqind e njëzet e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa T.V.SH, është lidhur në muajin dhjetor 2023, kontrata nr.517/26 prot., datë 12.12.2023. Për Lotin II - “ Sigurimi i shëndetit për gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, personat e lidhur të gjyqtarëve, këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, Sekretarin e Përgjithshëm, Drejtorët e Drejtorive, stafin administrativ dhe sigurimi i pasurisë”, Marrëveshja Kuadër nr. 67/9 prot., datë 02.10.2023, protokolluar në Kolegj me nr. 517/17 prot., datë 12.10.2023, nënshkruar midis Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqëndruara dhe operatorit ekonomik “ Sigal Uniqa Group Austria” SH.A. me fond të marrëveshjes 5,741,667 (pesë milionë e shtatëqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa T.V.SH,

për shkak të disa problematikave të konstatuara, nuk u arrit të nënshkruhet kontrata, si dhe në vijim me gjithë përpjekjet e bëra nuk u bë e mundur të realizohej me sukses zhvillimi i kësaj procedure deri në fund të vitit 2023. Për këtë gjendje po ndërmerren masa korrigjuese për vitin 2024, për të siguruar që realizimi i buxhetit të përmirësohet në periudhat në vijim.

2.2.4 Shpenzimet për Trans. për Buxh. Fam. & Individ (Ilogaria ekonomike 606)

Buxheti i detajuar në këtë zë është në vlerën 1.364 milionë lekë dhe realizimi 475 mijë lekë ose 35%.

Në këtë grup përfshihet fondi i veçantë në vlerën 264 mijë lekë, miratuar me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, si dhe fondi në vlerën 1.100 mijë lekë për mbulimin e shpenzimeve të telefonisë celulare për gjyqtarët e Kolegjit, transferuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 4290/1 prot., datë 09.03.2023, nga artikulli 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” në artikullin 606 “Trans. për Buxh. Fam. & Individ”.

Gjatë kësaj periudhe është kryer rimbursimi i shpenzimeve telefonike të gjyqtarëve sipas përcaktimit në VKM nr. 673, datë 02.09.2020, “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë”, të ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 28, datë 21.12.2020, të Mbledhjes së Gjyqtarëve, ndryshuar me Vendimin nr. 23, datë 05.02.2021, për vitin 2023, në vlerën 798.94 mijë lekë, si dhe pagesën në vlerën 90 mijë lekë, si ndihmë financiare për tre raste fatkeqësie në familje, sipas përcaktimeve në VKM nr. 929, datë 17.11.2020, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar.

2.2.5 Shpenzimet kapitale (231)

Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2023, në investime është 2 milionë lekë dhe përbën rreth 0,7% të buxhetit total vjetor të rishikuar. Buxheti i detajuar në zërin investime për vitin 2023, është 2 milionë lekë dhe realizimi 954 mijë lekë ose 47.7 %.

Këto fonde janë parashikuar për plotësimin e nevojave për punonjësit shtesë të miratuar në strukturën organike me vendimin e Kuvendit nr. 35/2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 92/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, si dhe të nevojave të tjera të institucionit, për pajisje kompjuterike në vlerën 1,2 milionë lekë dhe pajisje e mobilje zyre në vlerën 800 mijë lekë.

Gjatë vitit 2023, u realizuan procedurat e prokurimit për pajisje elektronike (kompjuter, laptop etj.) në vlerën 428 mijë lekë, pajisje e mobilje zyre në vlerën 444 mijë lekë dhe pajisje të tjera në vlerën 82 mijë lekë. Fondi i papërdorur lidhet me tavanin e shpenzimeve kapitale të alokuara me ligjin e buxhetit për vitin 2023. Fondi i cili ka rezultuar i papërdorur në investime është raportuar nga Kolegji në muajin dhjetor 2023, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në komunikim elektronik, si fond i lirë për vitin 2023.

Në lidhje me sa më sipër, bashkëlidhur gjeni anekset për raportimin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën e vitit 2023.

3 ANEKS 1 SITUACION I SHPENZIMEVE OPERATIVE 602 PËR VITIN 2023

<i>N/artik</i>	<i>Struktura e llogarive</i>	<i>Plan vjetor</i>	<i>Fakt</i>	<i>Plan-Fakt</i>	<i>Realizim %</i>
602	MALLRA DHE SHERBIME TE TJERA	18,040,000	11,687,261	6,352,739	65%
1	MATERIALE ZYRE DHE TE PERGJITHSHEME	904,000	826,040	77,960	91%
6020100	Kancelari, leter	574,000	573,440	560	100%
6020200	Materiale për pastrim e higjeno sanitare	285,000	237,600	47,400	83%
6020200	Materiale elektrike, ndricim etj	20,000	-	20,000	0%
6020400	Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale	10,000	-	10,000	0%
6020900	Furniz.dhe materiale tjera zyre dhe të përgj	15,000	15,000	-	100%
2	MATERIALE DHE SHERBIME SPECIALE	607,000	431,524	175,476	71%
6021001	Uniforma	24,000	24,000	-	100%
6021004	Furnizime dhe sherbime me ushqim per mencent	320,000	188,620	131,380	59%
6021007	Posta abonim ne shtypin e shkruar	63,000	46,620	16,380	74%
6021010	Shpenz.për prodhim dokumentacioni specifik (regjistra etj)	102,000	101,784	216	100%
6021099	Dezinfektim i ambienteve	48,000	30,000	18,000	63%
6021099	Të tjera mater.dhe shërbime speciale	50,000	40,500	9,500	81%
3	SHERBIME NGA TE TRETE	3,198,400	3,000,155	198,245	94%
6022001	Elektricitet	1,516,400	1,498,778	17,622	99%
6022002	Ujë	75,000	89,199	-	119%
6022003	Shërbime telefonike celulare	670,000	574,072	95,928	86%
6022003	Shërbime telefonike fiks	28,000	27,611	389	99%
6022004	Posta dhe shërbim korrieri	170,000	169,815	185	100%
6022010	Shërbime të printimit dhe publikimit	710,000	624,000	86,000	88%
6022099	Sherbim interneti per ambientet me qera	19,000	16,680	2,320	88%
6022099	Shërbime të tjera	10,000	-	10,000	0%
4	SHPENZIME TRANSPORTI	512,000	467,490	44,510	91%
6023100	Karburant dhe vajra	230,000	225,648	4,352	98%
6023200	Pjese kembimi, goma dhe bateri	24,000	23,700	300	99%
6023300	Shpenzime siguracioni të mjeteve	60,000	20,142	39,858	34%
6023900	Shpenzime të tjera transp (parkim per automjetin e institucionit)	198,000	198,000	-	100%
5	SHPENZIME UDHETIMI	764,000	734,870	29,130	96%
6024200	Udhetim jashte shtetit.	764,000	734,870	29,130	96%
6	MIREMBAJTJE TE ZAKONSHME	850,000	822,600	27,400	97%
6025500	Shpenz. Per miremb. E sistemeve dhe instalimeve teknike	64,000	32,800	31,200	51%
6025600	Shpenz.për mirëmb. e mjeteve të transportit	86,000	85,400	600	99%
6025800	Shpenzime per miremb. e paisjeve te zyrave	700,000	704,400	-	101%
7	SHPENZIME PER QERAMARRJE	1,450,000	1,428,000	22,000	98%
6026100	Shpenzime per qeramarrje ambjentesh	1,450,000	1,428,000	22,000	98%
8	SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE	9,754,600	3,976,582	5,778,018	41%
6029004	Shpenzime per sigurimin e jetes, shendetit dhe pronas	8,670,000	2,983,679	5,686,321	34%
6029006	Shpenz kompes per zyrtaret e zgjedhur (pasaporte diplomatike)	21,000	-	-	-
6029008	Shpenz.per tatim & taksa te paguara nga instit.	280,000	257,123	22,877	92%
6029099	MKZ	18,000	18,000	-	100%
6029099	Blerje materiale hidraulike, marangozi, ndertimi etj.	50,000	12,180	37,820	24%
6029099	Dekorimi i festave te fundvitit	10,000	-	10,000	0%
6029099	Blerje licensash Fireçall, Microsoft Office dhe Zoom Meeting	585,600	585,600	-	100%
6029099	Mirembajtje website kpa.al	120,000	120,000	-	100%